

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

Në bazë të nenit 157 paragrafi 1 pika 1, ndërsa në lidhje me nenin 185 nga Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15 dhe 173/15), Këshilli drejtues i Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 08.10 të vitit 2015 solli:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES MBI MËNYRËN DHE KUSHTET PËR SHITJEN DHE DHËNIEN E HAPËSIRËS AFARISTE ME QIRA NË PRONËSI APO SHFRYTËZIM TË PËRHERSHËM TË FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË

Neni 1

Në Rreguloren mbi mënyrën dhe kushtet për shitjen dhe dhënien e hapësirës afariste me qira në pronësi apo shfrytëzim të përhershëm të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 197/14), neni 17 ndryshohet dhe thotë:

“Hapësirën afariste në pronësi apo të marrë në shfrytëzim të përhershëm, Fondi mund t’ia japë në shfrytëzim Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë apo shoqatave komunale të pensionistëve për kryerjen e veprimtarisë së tyre me nënshkrimin e marrëveshjes për shfrytëzim pa kompensim”.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“

Nr. 02-5213/6
8 tetor të vitit 2015
Shkup

Këshilli drejtues
Kryetar,
Jasmina Ivanova, v.n.

A r s y e t i m

Duke marr parasyshtë se në Rregulloren mbi mënyrën dhe kushtet për shitjen dhe dhënien e hapësirës afariste me qira në pronësi apo shfrytëzim të përhershëm të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 197/14), në nenin 17 është rregulluar se Fondi mund t'ia japë në shfrytëzim hapësirën afariste Shoqatave të pensionistëve në komunat ku Fondi disponon me hapësirë afariste në shtëpitë e pensionistëve.

Me qëllim që të mundësohet ndarja e hapësirës afariste e cila është në pronësi të Fondit të SPIM-së apo e dhënë në shfrytëzim të përhershëm ndërsa e cila nuk është në rajonin në të cilin gjendet shtëpia e pensionistëve apo shoqata komunale, jepet mundësia që kjo hapësirë t'i jepet në shfrytëzim Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë apo shoqatave të pensionistëve për kryerjen e veprimtarisë së tyre, pa kompensim.

TEKSTI I DISPOZITAVE TË CILAT NDRYSHOJNË

Në rajonet e komunave në të cilat ekzistojnë shtëpi të pensionistëve me të cilat menaxhon Fondi, shoqatave të pensionistëve në kuadër të komunës, Fondi do t'u ndajë hapësirë afariste për kryerjen e veprimtarisë së tyre me nënshkrimin e marrëveshjes për shfrytëyimin e së njëjtës pa kompensim për qira.